

Janar 2025 | Nr. 45

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

EFIÇENCA E DREJTËSISË, ILD MIRATON KALENDARIN E INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2025





EFIÇENCA E DREJTËSISË, ILD MIRATON KALENDARIN E INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2025

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve planin e inspektimeve në prokurori e gjykata për vitin 2025.

Për të dytin vit radhazi, inspektimet tematike dhe institucionale janë prioritet i punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si instrument për të matur eficientë e drejtësisë në vend, por edhe konkluzion i takimit të posaçëm të punës, i mbajtur tetorin e kaluar, me Njësinë e Inspektorëve e atë të Ndhmës inspektorëve, për të adresuar gjetjet e dokumentit “Pozicioni i përbashkët i

Bashkimit Evropian”, në kuadër të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë për grupkapitullin e parë themelor.

Zvarritja e proceseve të punës nga gjyqtarë e prokurorë ka qenë shkak i evidentuar më shpesh, tek ankesat, që i janë drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2024, nga qytetarë por edhe institucione, të cilat kanë përcjellë propozime për inspektime tematike.

Në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve u evidentua, se nga përpunimi



i të dhënave mbi ankesat për gjykatat, numrin më të lartë të ankesave të shqyrtuara nga ILD, me objekt “zvarritje”, e ka Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndjekur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Gjykata Administrative e Apelit.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2024, gjykatat për të cilat nuk është paraqitur asnjë ankesë për zvarritje janë: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO).

Nga zyrat e Prokurorive, numri më i madh të ankesave të trajtuara me objekt “zvarritje”, i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke vijuar me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2024, prokuroritë për të cilat nuk ka patur asnjë ankesë për zvarritje, janë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit

Nga zyrat e Prokurorive, numri më i madh të ankesave të trajtuara me objekt “zvarritje”, i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke vijuar me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2024, prokuroritë për të cilat nuk ka patur asnjë ankesë për zvarritje, janë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit

Për të dytin vit radhazi, inspektimet tematike dhe institucionale janë prioritet i punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si instrument për të matur efencën e drejtësisë në vend, por edhe konkluzion i takimit të posaçëm të punës, i mbajtur tetorin e kaluar, me Njësinë e Inspektorëve e atë të Ndhmës inspektorëve, për të adresuar gjetjet e dokumentit “Pozicioni i përbashkët i Bashkimit Evropian”, në kuadër të hapjes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë për grupkapitullin e parë themelor.

të Përgjithshëm Berat, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Duke diskutuar mbi këto të dhëna dhe konstatimet e Njësisë së Inspektorëve dhe asaj të ndihmës-Inspektorëve, gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave në faza të ndryshme pune gjatë vitit 2024, Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve miratoi gjithsej 8 inspektime për t'u realizuar në vitin 2025, 7 inspektime tematike dhe 1 inspektim institucional.

Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve miratoi 3 inspektime tematike dhe 1 inspektim institucional, të përcaktuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konkretisht:

Inspektimi tematik “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik” do të realizohet në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Përgjithshëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit

të Përgjithshëm Shkodër, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”. Inspektimi pranë këtyre gjykatave do të kryhet në periudhën 01.04.2025-31.12.2025.

Inspektimi tematik “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve për periudhën 01.01.2024- 31.12.2024.” do të kryhet pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Ky inspektim do realizohet në periudhën 01.04.2025 – 31.12.2025.

Një inspektim tematik, pjesë e strategjisë së drejtësisë 2025- 2030 dhe e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës, në kuadër të procesit të integritetit në BE është “Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.05.2024 – 31.07.2024. Ky inspektim do kryhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Ju-

ridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë gjatë periudhës 10.02.2025 – 31.03.2025.

Inspektimi institucional “Mbi procesin e qarkullimit të dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari, deri në përfundimin e trajtimit të tij” do kryhet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024. Inspektimi do realizohet prej datës 15.04.2025 deri në 15.09.2025.

Në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve u diskutuan propozimet e ardhura nga institucionet si Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe u miratuan inspektimet tematike, konkretisht:

Inspektimi tematik “Mbi trajtimin e materialit kallëzues nga prokurori, në kuadër të elementeve të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”, do kryhet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nga data 01.04.2025 deri në 30.10.2025.

Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore do analizohet me inspektimin tematik “Mbi kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore me palë kundërshtarë për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024”, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe do kryhet nga data 15.04.2025 deri në 15.11.2025.

Inspektimi tematik “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë për periudhën 01.04.2024 – 30.06.2024.” do realizohet në periudhën 01.04.2025 – 30.09.2025. Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve ka miratuar propozimin e ardhur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke përcaktuar inspektimin tematik “Mbi çështjet e proceduara për herë të parë me kërkesë ose vendim-marrje të prokurorit për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Ky inspektim do realizohet në harkun kohor 01.03.2025 -31.10.2025.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2024, gjykatat për të cilat nuk është paraqitur asnjë ankesë për zvarritje janë: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJPAKKO).



PJESËMARRËS TË AIEN ZHVILLUAN NJË VIZITË STUDIMORE NË ILD

Pjesëmarrës të Akademisë së Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN) zhvilluan një vizitë studimore në ambientet e ILD-së, gjatë së cilës zhvilluan një bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, në kuadër të modulit “Shteti i së drejtës”.

Të angazhuar në administratën publike, institucione jo publike, organizata jo qeveritare, nga radhët e juristëve e medias, pjesëmarrësit e kësaj akademie u njohën nga z. Metani me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe sfidat e institucionit, si

Interesi i pjesëmarrësve të AIEN lidhej me dallimin mes funksioneve të ILD-së dhe institucionit paraardhës të procesit disiplinor, sa i takon mënyrës së kryerjes së inspektimeve, ecurinë e ankesave, aspekte të punës së ILD ndaj magistratëve dhe burimet njerëzore të Institucionit.



pjesë e rëndësishme e strukturës së re të krijuar nga reforma në drejtësi e më tej, të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Interesi i pjesëmarrësve të AIEN lidhej me dallimin mes funksioneve të ILD-së dhe institucionit paraardhës të procesit disiplinor, sa i takon mënyrës së kryerjes së inspektimeve, ecurinë e ankesave,





aspekte të punës së ILD ndaj magjistratëve dhe burimet njerëzore të institucionit. Në përgjigje të interesit të pjesëmarrësve, z. Metani foli edhe për filozofinë e punës së ILD-së, duke u ndalur tek dilema e diskutimit institucional për balancën mes besimit të publikut dhe besimit të magjistratëve tek institucioni, duke synuar kultivimin e frymës së pavarësisë në radhët e magjistratëve, bashkë me përgjegjshmërinë për ushtrimin me standarde të profesionit.

Bashkëbisedimi mes pjesëmarrësve të AIEN dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijoi me aspekte të qëndrueshmërisë së reformës në drejtësi, përparimin e saj, hapësirat për përmirësime në drejtim të rritjes së efektivitetit të procesit të mbikëqyrjes gjyqësore në Shqipëri etj. Në fund të bashkëbisedimit, pjesëmarrësit e Akademisë së Integritit Evropian dhe Negociatave zhvilluan një tur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Z. Metani foli edhe për filozofinë e punës së ILD-së, duke u ndalur tek dilema e diskutimit institucional për balancën mes besimit të publikut dhe besimit të magjistratëve tek institucioni, duke synuar kultivimin e frymës së pavarësisë në radhët e magjistratëve, bashkë me përgjegjshmërinë për ushtrimin me standarde të profesionit.

NGA VIZITA STUDIMORE E STUDENTËVE NGA AIEN





KLP PRANON PJESËRISHT KËRKESËN E ILD-SË PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT K.LL.

Në seancën e sotme Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi pjesërisht kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj magjistratit K.Ll., prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, duke i caktuar masën “Vërejtje publike”.

Hetimi disiplinor i ILD-së ndaj magjistratit ka nisur bazuar në ankesën e një qytetareje, të paraqitur përmes formularit online në faqen e ILD-së, me pretendimin për zvarritje të hetimit të procedimit penal nga ana e prokurorit K.Ll.

Hetimi disiplinor konkludoi se nga ana e prokurorit K. Ll. janë ndërmarrë veprime dhe mosveprime, të cilat kanë të bëjnë me mos përmbushje të pajustificuar të funksioneve gjatë hetimit, duke sjellë zvarritje të pajustificuar të akteve procedurale, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga ana e magjistratëve; mosveprimet e prokurorit

janë kryer me faj me dashje direkt, duke mos përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat, duke lënë pa veprime dosjen hetimore për një periudhë mbi 2 vjeçare.

Raporti hetimor i ILD-së vëren, se si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor është cënuar prestigji i figurës së prokurorit, si dhe është cënuar besimi i publikut të drejtësia, ndërsa kjo sjellje e papërshtatshme mund të krijojë terren për raste të tjera të ngjashme.

Duke marrë në konsideratë se magjistrati nuk ka masë disiplinore dhe nuk ka kryer shkelje tjetër disiplinore, ILD i propozoi KLP-së marrjen masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës” në masën 40 % për një afat një vjeçar ndaj prokurorit K.Ll., parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c” dhe neni 108 i ligjit “Për statusin”, kërkesë që u pranua pjesërisht nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që vendosi caktimin e masës “Vërejtje publike” për prokurorin K.Ll.

JANARI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Janar 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **120 ankesa** nga të cilat **119 të depozituara nga qytetarë** dhe **1 ankesë nga institucion**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **janar 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
26 vendime nga 48 praktika të trajtuara ⇒ 15 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar ⇒ 11 vendime arkivimi pas verifikimit	⇒ 2 vendime verifikimi	⇒ 2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për dy magjistratë (gjyqtarë)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,


në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Janar** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **8 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit **Janar 2025**,
Sektori i Ankesave dhe
Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ ka pritur **27 ankues**,
të cilët janë paraqitur në ambi-
entet e Zyrës së Inspektorit të
Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ ka realizuar **7 telefonata** me
qytetarë, të cilët kanë
kërkuar informacion mbi
fazën e ankesave të tyre ose
Informacion mbi plotësimin e
formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Janar 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **17 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER



📍 Përpunimi i ankesave në 2 ditët e fundit të 2024 #ILD

- ✅ 6751 të konfirmuara
- ✅ 5671 të trajtuara
- ✅ 1080 në proces trajtimi
- ✅ 204 në proces verifikimi
- ✅ 131 Magjistratë të hetuar
- ✅ 44 kërkesa për procedim disiplinor

? Si bëhet ankesë në #ILD? 📍

ild.al/sq/si-pranohen...

Translate post



Kënaqësi të mikprisja dje pasdite në #ILD e të bisedoja me pjesëmarrësit e #AIEN mbi punën tonë e mënyrën si ata e shohin zbatimin e reformës në drejtësi. Ndamë ide të vlefshme për forcimin e shtetit të së drejtës. #ILD #komunikim #edukimligjor

Translate post



From ild.al

3:54 PM · 18.1.25 From Earth · 116 Views



📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD ⚖️

- ✅ 6805 të konfirmuara
- ✅ 5675 të trajtuara
- ✅ 1129 në proces trajtimi
- ✅ 202 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar

📍 Më shumë ild.al

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na shkruani 📍 📍

ild.al/sq/ankete/




📍 Përpunimi javor i ankesave #ILD ⚖️

- ✅ 6836 të konfirmuara
- ✅ 5690 të trajtuara
- ✅ 1146 në proces trajtimi
- ✅ 195 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar

📍 Më shumë ild.al

? Keni pasur eksperiencë me ne? Plotësoni anketën 📍 📍

ild.al/sq/ankete/



JANAR 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara

© ILD




KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!